



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Doretuar Prijmljena/Prodato Received/Delivery	04.11.2022	viti god year	
Organ/Njesta Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shifra Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMBICK	6746/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.941/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Ilire Mehmeti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.941/2022 të datës 24.10.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi [redacted]

[redacted] kundër Vendimit me numër protokolli 1415 të datës 26.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike "Transferim në rast riskstruktumi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 04.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i inicuar sipas ankesës me numër A.nr.941/2022 të datës 24.10.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 24.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6411/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 1415 të datës 26.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë lidhur me transferimin e ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6411/2022 të datës 24.10.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokolli 4262/2022 të datës 22.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës; Plotësimin e ankesës e datës 25.10.2022; Vendimin me Nr. 142/2022 i datës 26.09.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Akt Emërimit AE.Nr.14/2022 i datës 28.09.2022. Vendimi i Këshillit A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar shkresat ndërlidhur me këtë çështje juridike-administrative, ka konstatuar që përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankuesit A.nr.941/2022 të datës 24.10.2022, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi sipas Akt-it të Emërimit Nr.Ref.1053/2014 të datës 16.07.2014 ka qenë i emëruar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin dhe Përkrahjen e Investimeve të Diasporës në ish Ministrinë e Diasporës, e cila pozitë është paraparë edhe me Rregulloren e re Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës mirëpo që për këtë pozitë janë ndryshuar kriteret e vendit të punës respektivisht kualifikimet e posaçme formale, me ç' rast ankuesi ka hyr në procesin e transferimit për shkak të ristrukturimit pasi që i njëjti nuk ka plotësuar kualifikime të posaçme formale lidhur me njohje të gjuhës angleze lidhur me pozitën Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin dhe Përkrahjen e Investimeve.

Ankuesi me datë 22.07.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të heshtjes administrative dhe mos sistemimit të tij në procesin e ristrukturimit. Këshilli gjatë vendosjes së ankesës së ankuesit të datës 22.07.2022 ka pranuar si provë shtesë edhe Vendimin me numër Nr.142/2022 dhe numër protokolli 1415 të datës 26.09.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë lidhur me sistemimin e ankuesit në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Koordinimin e Nismave Rajonale në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, ndërsa Këshilli me Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 ka shfuqizuar Vendimin Nr.142/2022 të datës 26.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë duke e obliguar Komisionin e Ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të rishqyrtoj rastin e sistemimit të ankuesit.

Andaj nisur nga gjendja faktike si me lartë, dhe duke qenë se objekti i ankesës A.nr.941/2022 të datës 24.10.2022 i referohet vendimit i cili është shfuqizuar nga Këshilli me Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, Kolegji mbi bazën e këtyre rrethanave vlerëson se objekti i ankesës respektivisht qëllimi i ankesës së ankuesit me numër A.nr.941/2022 të datës 24.10.2022 është bërë i pamundur - kotë, kështu që, në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos që të përfundohet procedura administrative e iniciuar sipas ankesës së ankuesit A.nr.941/2022 të datës 24.10.2022.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.941/2022

Ilire Shaqiri Mehmeti


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

